

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 5 dhe nenin 36, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.5/02), si dhe nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit për kulturën ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18), ndërsa sipas propozimit të Kryetarit të Komunës së Kërçovës, Këshilli i Komunës së Kërçovës, në seancën e mbajtur më dt. 26.12.2024, miratoi këtë:

P R O G R A M

Për financimin e aktiviteteve nga lëmia e kulturës nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje shoqatave të qytetarëve për vitin 2025

LËNDA E PROGRAMIT

Lëndë e këtij Programi janë aktivitete që do të realizohen gjatë vitit 2025, përmes të cilave do të zbatohen fushëveprimet e Komunës së Kërçovës, në lëminë e kulturës dhe do të definohet interesi lokal në kulturën.

Me këtë Program është përfshirë financimi dhe puna e institucioneve publike nga lëmi i kulturës, themelues i të cilave është Komuna e Kërçovës, financimi i veprimit rinor, amator dhe profesional në kulturë, përmes programave dhe projekteve të personave tjerë fizikë dhe juridikë, nga sfera e kulturës, që veprojnë në territorin e Komunës së Kërçovës, projektet e të cilëve dhe programet i përmbushin kriteret e përgjithshme dhe rregullat e dhëna në Konkurs, si programe nga lëmia e kulturës, përmes të cilave realizohet interesi lokal në kulturën e Komunës së Kërçovës.

Komuna e Kërçovës, në kuadër të kompetencave të veta në lëminë e kulturës:

Jep mbështetje institucionale dhe financiare institucioneve kulturore dhe projekte me rëndësi për Komunën e Kërçovës;

Bën kultivimin e folklorit, doket, zanatet e vjetra dhe vlera të ngjajshme kulturore;

Organizon manifestime nga lëmia e kulturës, nxit forma të ndryshme specifike të krijimtarisë dhe

Shënon ngjarje dhe persona me rëndësi për komunën.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi kryesor i Programit për financimin e aktiviteteve nga lëmia e kulturës, me interes për Komunën e Kërçovës, për vitin 2025, është që ta definojë interesin lokal në kulturën, përmes përkrahjes të formave bashkëkohore dhe të reja të veprimit në lëminë e kulturës dhe artit, përkrahje të vlerave më të vërtetuara në kulturë dhe art, përkrahje dhe nxitje të formave të ndryshme të deklarimeve tradicionale të banorëve të Komunës së Kërçovës, promovimi i trashëgimisë kulturore, punën e institucioneve publike në fushëveprim të Komunës së Kërçovës, për shënimin e ngjarjeve dhe tjera, në kuadër të autorizimeve ligjore.

I. Financimi i interesit lokal në kulturën e Komunës së Kërçovës, si dhe realizimi i këtij programi do të zhvillohet përmes tetë (8) segmenteve programore:

Nr.	Segmenti programor dhe përshkrim i shkurtër	Shuma e mjeteve (në denarë)
1.	<p>Organizimi i festivaleve</p> <p>Në kuadër të Programit për Kulturë të komunës për vitin 2025, organizimi i festivaleve do të përbëjë një segment kyç për zhvillimin e skenës kulturore, promovimin e artit dhe kulturës lokale, si dhe për mbështetje të turizmit dhe komunitetit. Festivale do të organizohen me qëllim që të mundësohet shprehje të ndryshme kulturore dhe artistike, të stimulohen industritë krijuese dhe të krijohet një platformë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe shkëmbim përvojash.</p>	<p style="text-align: right;">500.000</p>
2.	<p>Financimi i manifestimeve kulturore</p> <p>- Projektet dhe puna që do të realizohet përmes interesit lokal në kulturë dhe të interesit të veçantë për Kërçovën. Ky program përfshin aktivitetet, ngjarjet, veprat dhe projektet nga fusha e kulturës, si pjesë e aktiviteteve të programit që do të zbatohen nga OJQ-të, nga fusha e kulturës dhe programeve arritja e të cilëve do të jetë nën kompetencën e Seksionit të kulturës në Sektorin, ndërsa do të realizohet nga palë tjera të zgjedhur me anë të procedurës së duhur.</p>	<p style="text-align: right;">800.000</p>
3.	<p>Projekte të organizatave joqeveriate</p> <p>Shoqëria civile është baza e zhvillimit ekonomik, kulturor të një vendi, komuniteti qytetar në kuadër të Komunës së Kërçovës paraqet një organizim të madh dhe të shumëllojshëm. Pjesa më e madhe e organizatave qytetare të cilat janë regjistruara në territorin e Komunës së Kërçovës, aktivitetin e tyre e bazojnë në nivel lokal, por ka edhe të atillë që kanë aktivitete nacionale. Për këtë potencial të sektorit qytetar, por edhe kompetencat e Komunës në këtë lëmi, e vendos si nevojë definimin e bashkëpunimit në mes Komunës dhe organizatave qytetare.</p>	<p style="text-align: right;">600.000</p>
4.	<p>Promovimi i Trashëgimisë Kulturore</p> <p>Duke ndjekur vazhdimësinë e kulturës si traditë e më shumë shtresave civilizuese, është detyrim i secilit institucion në Republikën e Maqedonisë së Veriut,</p>	<p style="text-align: right;">400.000</p>

	<p>duke përfshirë edhe komunat, për të evidentuar dhe regjistruar edhe në kuadër të mundësive të veta, të rindërtojnë dhe restaurojnë trashëgiminë kulturore. E njëjta gjë duhet të zbatohet për objektet të cilat janë gjetur në traditat shpirtërore, zakonet, folklori, llojet e ndryshme të ekspozitave të muzeut, monumentet, por edhe njerëzit që kanë lënë shenja në kulturën e komunës dhe njerëzve në përgjithësi. Nga ana tjetër, trashëgimia kulturore do të rigjallërohet dhe krijohet nga përvoja artistike (muzikës, teatrit, artit figurativ, filmit, muzikë etnik), si dhe afirmimin e tij.</p>	
5.	<p>Inkurajimi i krijimtarisë bashkëkohore përmes veprimtarisë botuese dhe biblioteka</p> <p>Fokus të veçantë ka nevoja kulturore e të rinjve, duke marrë parasysh perspektivën e zhvillimit kulturor, fokus i veçantë do të vendoset në sigurimin material supozime për krijimtarinë dhe plotësimin e nevojave kulturore të të rinjve. Do të mbështeten dhe inkurajohen hulumtimet dhe kërkimet për mjete të reja të shprehjes, do të mbështeten eksperimente dhe përdorimi i mediave të reja të shprehjes estetike, si dhe projektet dhe institucionet që merren me prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes dhe vlerave kulturore për të rinjtë.</p> <p>Kjo masë është e destinuar për botime të ndryshme dhe pasurimin e bibliotekave në Komunën e Kërçovës si biblioteka e qytetit ashtu edhe bibliotekat shkollore. Komuna e Kërçovës ka për detyrë që t'i mbështesë shkrimtarët dhe artistët e lëmive të ndryshme si ato që merren me veprimtari muzikore, me art, filmografi dhe të tjera, t'i perkohet në aktivite për botimin e veprave të tyre. Me këtë Komuna e Kërçovës, do të kontribuojë në pasurimin e literaturës, shkencës dhe artit në Kërçovë dhe më gjërë.</p>	400.000
6.	<p>Financimi i artistëve individualë, arteve zbatuese, dhe të ngjajshme</p> <p>Qendra e kulturës është njeriu dhe potenciali i tij krijues. Në Kërçovë dhe në të gjithë Republikën e Maqedonisë së Veriut autorët e humbasin interesin dhe motivimin për të punuar, krijimin, përmisimin profesional dhe paraqitjen e tyre. Në mungesë të mundësive materiale për të shprehur potencialin e vet të autorit dhe potencialin e krijuesëve të mëdhenj, janë të detyruar të punojë gjëra të tjera duke u larguar nga veprimtaria e tyre bazë. Një nga objektivat e rëndësishme të Programit të Kulturës në Komunën e</p>	300.000

	Kërçovës, janë subvencionet për artistë dhe ndihma në realizimin e projekteve kreative që të kthehet dinjiteti i krijuesve dhe në këtë mënyrë kultura dhe kreativiteti, jo vetëm që do të jetë mirë, por do të jenë edhe veprimtari prestigjioze për punë dhe jetesë.	
7.	<p>Financimi i projekteve nga lëmia e veprimtarisë dramatike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekte që në vitin 2025 shënojnë përvjetore dhe data të rëndësishme të artit dhe dramës të autorëve vendas; - Projekte që inkurajojnë pjesëmarrjen e dramaturgëve të rinj nga Republika e Maqedonisë së Veriut; - Projekte rajonale të lëvizshme (projekte në brendësi të vendit, vendbanime urbane dhe periferike, qendra dhe shtëpi kulturore; - Vendosja e teksteve të dramës nga autorë të njohur vendas dhe dramaturg botërorë, vepra të reja që nuk janë vënë në skenat tona deri më tani, kanë një avantazh; - Mbështetje për amatorizmin dramatik; - Manifestime dhe festivale që kontribuojnë në afirmimin e veprimtarisë së dramës. 	400.000
8.	<p>Sanimin e përkujtimeve kulturore-historike në komunë</p> <p>Sanimi i përkujtimeve kulturore - historike është një aktivitet që synon të nderojë dhe të përkujtojë ngjarjet dhe figurat historike të rëndësishme që kanë formësuar identitetin dhe trashëgiminë kulturore të Komunës së Kërçovës. Kjo ngjarje forcon lidhjet mes brezave, promovon një sens të përbashkët identiteti kombëtar dhe komunitar dhe kontribuon në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike dhe kulturore të Kërçovës.</p>	300.000

II. Burime dhe mënyra të financimit

Burime të financimit:

- Buxheti i Komunës së Kërçovës;
- Buxheti i RMV-së;
- Burime tjera nga donatorë.

Mjetet e përcaktuara për manifestime të caktuara plotësuese, projekte dhe shfaqje, do t'i orientojë Kryetari i Komunës së Kërçovës, për aktivitete të cilat nuk janë përfshirë me këtë program, ndërsa me aktivitetin e tyre, rëndësinë dhe cilësinë, kontribuojnë në realizimin e qëllimeve programore në lëminë e kulturës.

Për pikat I.1, I.2, I.4, dhe I.7 Komuna e Kërçovës, me shpallje publike, do të shpërndajë mjete të parapara me këtë program, ku mund të konkurojnë të gjithë organizatat joqeveritare dhe organizata tjera kulturore.

Në pikën I.3 do të finansohen projekte dhe programe të OJQ për të cilat nuk ka shpallje publike, por janë në interes të zhvillimit të OJQ të Kërçovës dhe RMV dhe shqyrtohen nga komisioni për kulturë.

Pika I.5, Komisioni për kulturë, i formuar nga Kryetari, i shqyrton kërkesat e arritura dhe jep propozim deri te kryetari i komunës për financimin e tyre.

Pika I.6, ndahen mjete për persona fizikë artistë, artistë individualë, të cilët do të drejtohen deri te Komuna e Kërçovës, me kërkesë konkrete për aktivitetin ose veprën. Kryetari ndan mjete deri më 30.000,00 den.

Pika I.12 financohet nga Buxheti i RMV-së dhe burime tjera nga donatorë.

Komuna e Kërçovës, gjithashtu, mund ta realizojë interesin lokal në kulturë në vitin 2025 edhe nëpërmjet sigurimit të logjistikës dhe mbështetje institucionale të projekteve dhe aktiviteteve të autorëve tjerë nga lëmia e kulturës, të cilat janë të financuara nëpërmje Buxhetit të Komunës së Kërçovës, për vitin 2025, në qoftë se, vërtetohet se janë në interes të posaçëm dhe vlerë të posaçme për Komunën e Kërçovës.

III. Manifestime dhe shfaqje të cilat do të mbështeten dhe ndihmohen në forma dhe aktivitete tjera

Forma tjera dhe aktivitete me të cilat do të mbështeten dhe ndihmohen manifestimet kulturore, ngjarje dhe projekte, janë si në vijim:

- Nën mbështetje (patronazh) të Komunës së Kërçovës,
- Ndarje të çmimeve, dhurata dhe të ngjajshme,
- Sigurimi i mbështetjes profesionale, teknike dhe mbështetjes tjetër me kuadro dhe paisje me të cilën disponon Komuna e Kërçovës;
- Pjesëmarrje të përfaqësuesve të Komunës së Kërçovës, gjatë organizimit të takimeve protokolare dhe promotive, mbajtjen e manifestimeve dhe realizimin e projekteve nga lëmia e kulturës.

IV. Dispozitat përfundimtare

Kryetari i Komunës së Kërçovës, kujdeset dhe e siguron zbatimin e këtij Programi.

Spektori për Arsim, Kulturë, Sport, Shëndetësi, Mbrojtjen Sociale dhe të fëmijëve - Njësia për kulturë dhe sport e përgatit këtë Program dhe e ndjek realizimin e tij.

Komisioni për kulturë në Këshillin e Kërçovës jep iniciativa dhe mendime në lidhje me këtë Program.

Kërkesat e arritura jashtë shpalljes publike dhe kërkesat për finansim të projekteve nga organizatat joqeveritare shqyrtohen nga Komisioni për kulturë, i cili jep propozime për finansime.

Pas propozimit të komisionit, kryetari i komunës sjellë një aktvendim për financimin e projektit të përmendur – programit, ndërsa ato të jenë në kuadër të këtij programi.

Për përcaktimin e programit vjetor dhe për mjetet financiare për realizim të tij, Komuna e Kërçovës dhe bartësit e projekteve – shfrytëzues të mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2025, lidhin kontrata.

Ky Program hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të shpallet në “Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës”.

Nr.08-3237/27
Dt. 26.12.2024
K ë r ç o v ë

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS
Kryetar,
Skender Xhabiri
